



## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Midis

Odës së infermierëve

Dhe

**Asociacionit Kosovar të personave që jetojnë më HIV/AIDS - KAPHA**

Për

**Bashkëpunim në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional për  
infermierët me qëllim të përmirësimit të shërbimeve shëndetësore për personat  
që jetojnë me HIV dhe AIDS në Kosovë**

DUKE PASUR PARASYSH qëllimin Organizatës Joqeveritare, Asociacioni Kosovar i Personave që Jetojnë më HIV/AIDS – KAPHA për të bashkëpunuar me Odën e infermierëve, me qëllim të zhvillimit profesional për infermierët për etikën profesionale, të drejtat e njeriut, reduktimin e stigmës dhe zhvillimin dhe shpërndarjen e standardeve të praktikave të mira; dhe

DUKE PASUR PARASYSH qëllimin e Odës së infermierëve për të siguruar arsimin të vazhdueshmë profesional cilësor për infermierët në bazë të metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe zhvillimit të shkathtësive profesionale praktike;

Palët pajtohen si në vijim:

### **Neni 1**

#### **Qëllimi i këtij Memorandumi:**

- 1.1 Ky Memorandum i Mirëkuptimit ka për qëllim të vendosë një bashkëpunim midis Odës së infermierëve (në tekstin e mëtejmë: OI) dhe Organizatës Joqeveritare, Asociacioni Kosovar i Personave që Jetojnë më HIV/AIDS – KAPHA (në tekstin e mëtejmë: KAPHA), për zbatimin e aktiviteteve në kuadër të Programit: Përmirësimi i kualitetit të jetës se personave që jetojnë më HIV/AIDS në Kosovë, i përkrahur nga granti i Fondit Global.
- 1.2 Përmes këtij memorandumi do të arrihet planifikimi dhe zbatimi i moduleve të trajnimeve në kuadër të Edukimit të Vazhdueshmë Profesional për infermierët për etikën profesionale, të drejtat e njeriut, reduktimin e stigmës dhe zhvillimin dhe shpërndarjen e standardeve të praktikave të mira.
- 1.3 Përmes këtyre aktiviteteve synohet krijimi i një ambienti përkrahës dhe që ofron qasje të barabartë për personat që jetojnë me HIV/AIDS në Kosovë dhe popullatat kyçë, në shërbimet shëndetësore dhe të përmbushjes së objektivave dhe caqeve që dalin nga Programi Kombëtar për HIV/AIDS.

### **Neni 2**

#### **Oda e infermierëve**

- 2.1 Oda e infermierëve synon të inkorporojë në programin për zhvillim të vazhdueshmë profesional modulet për etikën profesionale, të drejtat e njeriut, reduktimin e stigmës dhe zhvillimin dhe shpërndarjen e standardeve të praktikave të mira.
- 2.2 Oda e infermierëve synon të bëjë përpjekje që modulet e zhvilluara me ndihmën teknike të KAPHA, sipas mundësive, t'i zbatojë edhe në të ardhmen.
- 2.3 Oda e infermierëve synon të bashkëpunojë ngushtë me KAPHA në dizajnimin e moduleve dhe zbatimin e moduleve të trajnimeve për etikën profesionale, të drejtat e njeriut, reduktimin e stigmës dhe zhvillimin dhe shpërndarjen e standardeve të praktikave të mira.

- 2.4** Oda e infermierëve synon të bashkëpunojë me KAPHA edhe për planifikimin dhe zbatimin e moduleve të trajnimeve të cilat mund të dalin si nevojë në të ardhmen.
- 2.5** Oda e infermierëve synon të bashkëpunoj me KAPHA në përmirësimin e standardeve të kujdesit dhe zbatimin e tyre ne shërbimet Shëndetsore në nivel kombëtar.
- 2.6** Oda e infermierëve synon të bashkëpunoj me KAPHA në përmirësimin dhe parandalimin e përhapjes të HIV infeksionit, në Meknizmi Kordinues Kombëtar (MKK) si dhe Komitetin Kosovar kundëri HIV/AIDS-it

### **Neni 3**

#### **Obligimet e Asociacionit Kosovar i Personave që Jetojnë më HIV/AIDS – KAPHA**

- 3.1** KAPHA synon që të ofrojë përkrahje teknike dhe profesionale Oda e infermierëve për planifikimin dhe implementimin e moduleve të trajnimeve për infermierët në kuadër të zhvillimit të vazhdueshëm profesional për etikën profesionale, të drejtat e njeriut, reduktimin e stigmës dhe zhvillimin dhe shpërndarjen e standardeve të praktikave të mira.
- 3.2** KAPHA synon që të mbulojë financiarisht dizajnimin e moduleve etikën profesionale, të drejtat e njeriut, reduktimin e stigmës dhe zhvillimin dhe shpërndarjen e standardeve të praktikave të mira.
- 3.3** KAPHA synon që të mbulojë financiarisht shpenzimet për ligjërueshet e moduleve për etikën profesionale, të drejtat e njeriut, reduktimin e stigmës dhe zhvillimin dhe shpërndarjen e standardeve të praktikave të mira.
- 3.4** KAPHA synon që të mbulojë financiarisht shpenzimet logistike rreth organizimit të trajnimeve.
- 3.5** KAPHA synon që modulet të dizajnohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, për mbrojtjen e të dhënavë personale dhe mos-diskriminim.
- 3.6** KAPHA do të jetë në konsultim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me Oda e infermierëve përgjatë zbatimit të këtij memorandumi.

### **Neni 4**

#### **Zbatimi**

- 4.1** Palët pajtohen se do të përkujdesen për zbatimin me përkushtim dhe përpikëri të kësaj marrëveshje.

**Neni 5**

**Vlefshmëria kohore**


- 5.1** Palët nënshkruese u pajtuan që vlefshmëria kohore e këtij memorandumi të mbetet në fuqi deri në momentin e përfundimit të Programit të Fondit Global dhe shqyrtimit te vazhdimësisë së bashkëpunimit edhe në periudhën e tranzicionit, gjegjësisht kur njëra nga palët nënshkruese tërhiqet me paralajmërim paraprak me shkrim.

**Neni 6**

**Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**


- 5.1** Marrëveshja është nënshkruar në katër (4) kopje identike origjinale, nga dy (2) kopje për secilën palë nënshkruese dhe e njëjtë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët.

Për Odën e infermierëve:



Nënshkruar me datë: \_\_\_\_\_

Për KAPHA:

  
  
Alban Gjonshka  
19/06/2014